



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 77

Prishtinë, më 13.09.2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C 203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selviqe Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

Munguan: Doruntinë Maloku dhe Donika Kadaj- Bujupi.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Milinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Gresa Ramadani, vizitore; Ardian Nikolla, gazeta 'Zëri'; Dibran Istrefi, Klan Kosova; Ardian Bajraktari, MD; Dren Ajeti- GSJP; Petrit Daku- KTV; Granit Berisha e Egzon Pacolli, praktikant dhe Shpresa Veliqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 17,20,22,28 qershor dhe 11,12 korrik 2016;
3. Shqyrtimi i raportit të punës për sesionin pranveror 2016;
4. Shqyrtimi i propozimeve për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga shoqëria civile;
5. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarit në Komision për kërkesa pronësore;
6. Shqyrtimi i shkresës së dërguar nga Avokatura Shtetërore;

7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent;
9. Të ndryshme.

- Zëvendësimi i kryesuesit të Grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Rishikimi i planit të punës për sesionin vjeshtor;
- Caktimi i datës për raportim të ministres së Drejtësisë znj. Dhurata Hoxha, lidhur me mos zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion për ndryshim dhe plotësim të ligjeve për Këshillin Gjyqësor dhe Prokuriaial të Kosovës;
- Vizita në Shqipëri nga 'Lëvizja Fol'.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 17, 20, 22, 28, qershor dhe 11 e 12 korrik 2016.

Kryetarja konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 17, 20, 22, 28 qershor dhe 11, 12 korrik 2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2016.

Kryetarja në fjalën e saj tha se e kam lexuar raportin e punës në përpikëri dhe i kam dy kritika për Komisionin për Legjislacion lidhur me numrin e mbikëqyrjes së ligjeve dhe vizitat e realizuar brenda vendit. Sa i përket mbikëqyrjes së ligjeve në vazhdimësi, kur flitet për planin e punës ne kemi ambicie për të mbikëqyrur legjislacionin duke e ditur faktin se Kosova ka ligje të mira, por problemi ekziston te mos zbatimi i këtyre ligjeve në praktikë dhe është mangësi e Komisionit për Legjislacion që nuk kemi arritur të mbikëqyrim asnjë ligj gjatë kësaj periudhe. Mendoj të diskutojmë se gjatë sesionit vjeshtor duhet t'i mbikëqyrim disa ligje që janë problematike në zbatim të tyre. Ne, si komision, kemi dështuar që t'i vizitojmë institucionet e ndryshme jo vetëm për zbatimin e ligjeve, por edhe për sfidat që ballafaqohen institucionet që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion. Po ashtu znj. Haxhiu pati vërejtje lidhur me procedimin e projekt-ligjeve në Kuvend ku tha se në strategjinë Legjislative që miratohen në Kuvend parashihen dhe afatet kohore të procedimit të projektligjeve në komisionet përkatëse ku Qeveria asnjëherë nuk po i zbaton këto afate kohore. Ne e kemi një shembull të keq me pakon e ligjeve për sistemin e drejtësisë ku për një kohë shumë të shkurtër për shkak se Qeveria nuk i pati respektuar afatet jemi detyruar që për pesë ditë t'i shqyrtojmë 5 projektligje në procedura të përshpejtuara. Komisioni për Legjislacion është në procedurë të mbikëqyrjes së dy ligjeve: Ligjit për Provimin e Jurispondencës dhe Ligjit për Deklarimin e Pasurisë, mirëpo deri tani nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij tha se raporti i punës tregon edhe mënyrën e punës se si janë zhvilluar seancat plenare, por edhe të Komisionit për Legjislacion. Pavarësisht pengesat që ka pasur Komisioni ka punuar në mënyrë intensive me të gjitha kapacitetet që i ka pas në shfrytëzim, por edhe në bazë të rrethanave të numrit të deputetëve dhe interesimit të grupeve të tjera parlamentare. Kam insistuar edhe herën e kaluar që raportet të jenë më të plotësuar, sepse duhet të shikohet edhe puna individuale edhe e deputetëve. Komisioni për Legjislacion dihet që është një ndër komisionet kryesore të Kuvendit për shqyrtimin e amendamenteve të komisioneve funksionale për bazë juridike dhe ajo që u potencua me të drejtë mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve. Në kuadër të kësaj që u tha, pavarësisht angazhimeve që ka pasur Kuvendi, Komisioni për Legjislacion ka qenë më i angazhuar dhe ka arritur që me punën e vet të nxjerrë edhe produktet e saj, siç janë shqyrtimi dhe miratimi i projektligjeve, nxjerrja e raporteve të institucioneve që janë në fushëveprim të Komisionit tonë dhe sidomos shqyrtimi i kërkesave të institucioneve të ndryshme publike apo private. Në planin e ri të punës duhet të jenë edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit dhe vizitat e institucioneve që bien në fushëveprimin e Komisionit dhe të ketë një dinamikë më të madhe të punës që mund të shfrytëzojmë këtë kohë të mbetur për të rishikuar pengesat dhe mangësitë që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit të cilët janë miratuar tani, por edhe ligjet që janë miratuar më parë. Pavarësisht raporteve politike puna në Komision më shumë është punë profesionale dhe vetë numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësi të komisionit kryesor të cilat janë 706 amendamente, 7 projektligje të miratuara dhe shqyrtimi i raporteve vjetore të institucioneve raportuese. Më tej z. Zemaj tha se si të tillë e përkrah raportin e punës së sesionit pranveror.

Selviqe Halimi- Në fjalën e saj tha se sa i përket raportit të punës së sesionit pranveror është mirë që ne, si komision, jemi vetëkritikë, por mirë do ishte që secili të analizoj vetë kontributin e vet rreth punës që ka bërë komisioni në cilësinë e Komisionit Funkcional dhe në cilësinë e komisionit të përhershëm. Angazhimi dhe puna që kanë bërë deputetët në këtë sesion është për t'u lavdëruar duke pasur parasysh rrethanat të cilat është punuar. Vizita në Agjencinë Kundër Korrupsion, e cila ka përkuar edhe me vetë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë nuk është realizuar pasi komisioni ka nxjerrë një konkludim për shkak se në ata periudhë komisioni kishte shpallur konkursin për përzgjedhjen e drejtorit të ri të Agjencisë Kundër Korrupsion dhe vetë fakti që disa zyrtarë të këtij institucioni kishin aplikuar në këtë konkurs, ne e kemi parë të arsyeshme që për t'iu shmangur çdo lloj interpretimi në procesin e përzgjedhjes së drejtorit kemi ardhur në përfundim që vizita të shtyhet pas zgjedhjes së drejtorit të ri të Agjencisë Kundër Korrupsion. Po ashtu kemi pritur që komisioni të jetë i kompletuar sepse veprimtaria që kryen Komisioni për Legjislacion, mbikëqyrja e ligjeve që janë në fushën e këtij komisioni janë çështjet më të ndjeshme dhe duke i pasur parasysh që kritikën më të mëdha vinë për sistemin e drejtësisë dhe korrupsionin kemi menduar që momenti më i përshtatshëm do ishte kur Kuvendi të ishte më i kompletuar dhe qoftë në vizita apo në mbikëqyrje të marrin pjesë të gjithë anëtarët e komisionit. Gjithashtu në sesionin vjeshtor janë të parapara të mbikëqyrjen edhe 2 ligje dhe unë mendoj se grupet punuese tashmë në përbërje të plotë do të dalin në terren dhe do të bëjnë mbikëqyrjen e rekomandimeve të cilat janë aprovuar nga Kuvendi vitin e kaluar për ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, të cilat i kemi dërguar në Ministrinë e Drejtësisë dhe mekanizmat e tjerë. Ndërkaq, shtoi se anëtarët e komisionit duhet të punojnë në mënyrë më intensive gjatë sesionit vjeshtor dhe raportin si të tillë znj. Halimi e përkrah.

Agim Aliu – Në fjalën e tij tha se mendoj se ne nuk jemi duke shqyrtuar raport vjetor të punës së komisionit, por jemi duke shqyrtuar një raport 6 mujor të punës së komisionit dhe duhet çmuar nga të gjithë ne se vetë anëtarët e komisionit nga pozita po reflektojnë dhe po shprehin zërin e kritikës që ka mundur të bëhet më shumë. Komisioni pas një kohe të gjatë tashmë është bashkë në sesionin vjeshtor dhe në muajt në vijim ne mund të përmbushim axhenden e planit vjetor të punës së komisionit. Përkundër kësaj nënkryetarja dhe anëtarët e komisionit në shumë takime kemi shprehur dëshirën që të jenë dhe anëtarët e opozitës që vërtet të jetë zë i kundërt në komision, megjithëse edhe nga ana jonë nuk është se ka munguar debati. Madje kemi qenë shumë kritik të 5 raportet vjetore të institucioneve raportuese. Dua të përmend 7 ligjet që janë miratuar nga komisioni jonë dhe të vlerësoj 2 nga ato që kanë qenë ligje shumë të veçanta që tregojnë punën serioze të komisionit *Ligji për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës* dhe po ashtu ligji që për herë të parë u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës *Ligji për Kundërvajtje*.

Valdete Bajrami- Në fjalën e saj tha se nuk më takon të flas lidhur me raportin e punës, sepse unë nuk kam qenë pjesë e komisionit dhe shpresoj që këto ditë sa kanë mbetur Nisma do ta jap kontributin e saj në këtë komision. Puna jonë kryesore, si deputet të Kuvendit të Kosovës, bëhet në Komisionet Parlamentare, e jo në Seanca Plenare.

Pas diskutimeve nga anëtarët e Komisionit, kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash 8 për dhe 1 abstenim nxori këtë:

P e r f u n d i m

Miratohet Raporti i Punës për Sesionin Pranveror 2016.

4. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga shoqëria civile

Kryetarja- Në fjalën e saj tha se me sa jam e informuar kjo çështje është duke pritur që nga viti 2016 për faktin se ish -anëtari i KPK-së, z. Florent Muçaj, është ankuar në Gjykatën Kushtetuese për shkurtimin e mandatit që i është bërë me Legjislacion e ri. Tani kemi një Aktvendim të Gjykatës Kushtetuese, të cilën e ka shpallur të papranueshme kërkesën e z. Muçaj dhe i njëjti ka bërë ankesë edhe në gjykatë. Jemi njoftuar nga Këshilli Prokurorial që kanë shpallur konkurs publik për pozitën e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile duke u bazuar në ligj. Këshilli ka shqyrtuar përshtatshmërinë e kandidatëve të nominuar dhe nga 4 kandidaturat e paraqitura, Shemsi Jashari, Ilir Dukolli dhe Naim Krasniqi i plotësojnë kriteret e parapara në konkurs, ndërsa kandidati Hajrullah Mustafa, në bazë të dokumentacionit që ka paraqitur në Këshill, nuk i plotëson kriteret e parapara me konkurs. Unë i kam lexuar CV e tyre dhe kandidati Hajrullah Mustafa nuk i ka plotësuar kriteret për shkak se nuk i ka të paraqitura 5 organizata të shoqërisë civile të cilat e kanë përkrahur në këtë konkurs, ndërsa tre të tjerët i kanë të plotësuar. Mendimi im personal është që Këshilli Prokurorial i Kosovës të shikojë mundësinë që të rishpallë konkursin me faktin se nuk është respektuar parimi i barazisë gjinore. Mirëpo edhe për faktin se kanë aplikuar shumë pak kandidatë. E kam vendosur në rend të ditës se të gjithë këta që kanë aplikuar në vazhdimësi kanë kërkuar nga

Komisioni për Legjislacion që të procedojmë përpara. Znj. Haxhiu më tej kërkoi nga anëtarët e komisionit që të marrin fjalën.

Armend Zemaj- Propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme që CV-të e kandidatëve të shqyrtohen me hollësi, sepse edhe për njërin kandidat është thënë se nuk i plotëson kriteret dhe mbi të gjitha na intereson të dimë nga kanë ardhur këto nominime për këto kandidat që përfaqësojnë në të ardhmen shoqërinë civile sepse e dimë të gjithë se si ka qenë kundërshtimi i OJQ-ve në të kaluarën apo edhe kundërshtimi medial i këtyre OJQ-ve dhe nëse është çdo gjë në harmoni me ligjin i procedojmë për Seancë Plenare. Po ashtu në të njëjtin mendim ishte edhe znj. Halimi për t'u shtyrë kjo pikë në mbledhjen e ardhshme duke i shqyrtuar me hollësi CV-të e kandidatëve.

Kryetarja- Në fjalën e saj të sërishme tha se 3 kandidatët i kanë organizatat që i kanë nominuar, por problemi qëndron se nuk i kanë pas vetes Organizatat që në vazhdimësi e kanë përcjellë punën e KPK-së. Po ashtu ne duhet t'i shkruajmë edhe Odës së Avokatëve sepse ende Oda e Avokatëve nuk ka dërguar emër për KPK për shkak se janë ankuar me ndryshimet e fundit të legjislacionit.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

5. Shqyrtimi propozimeve për emërimin e anëtarit në Komision për kërkesa pronësore

Kryetarja - Në fjalën e saj tha se kemi 2 propozime të Gjykatës Supreme; Drita Rexhaj-gjyqtare dhe prof. dr. Avdulla Aliu dhe njëri prej tyre duhet të shkojë për seancë.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij tha se në bazë të referencave të dy kandidatët i plotësojnë kushtet, por pasi që mandati është njëvjeçar dhe profesori Avdulla Aliu ka qenë këtë vit do të ishte mirë që t'i vazhdohet sërish mandati edhe këtë vit.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni me 7 vota për dhe 2 vota abstenim nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- I. Të emërohet Avdulla Aliu, anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore;
- II. Mandati i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore është 1 (një) vit dhe fillon nga data 24 tetor 2016.

6. Shqyrtimi i shkresës së dërguar nga Avokatura Shtetërore

Kryetarja- Informoi se më 8 korrik është takuar me zyrtarët e Avokaturës Shtetërore ku ato kishin shprehur brengat e tyre edhe pse ligji ka kaluar për Avokaturën Shtetërore në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ata ende kanë mbetur zyrtarë ligjorë dhe jo avokatë të shtetit. Këta zyrtarë kanë bërë ankesë për Heset Mazrekaj, i cili është Avokat i Përgjithshëm i Shtetit. Unë propozoj që si Komision ta bëjmë një vizitë në këtë institucion dhe nga afër të njoftohemi me problemet që ballafaqohen ata. Po ashtu këtë shkresë mendoj t’ia përcjellim ministres së Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, për shkak se Kuvendi nuk ka të drejtë ta shkarkoj Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, sepse nuk e kemi zgjedhur ne.

Selviqe Halimi- Njoftoi se më herët ka ardhur e njëjta shkresë në komision dhe ne e kemi shqyrtuar si të pa bazë sepse Avokati i përgjithshëm i shtetit nuk i raporton komisionit, por Ministrisë së Drejtësisë. Unë mendoj që fillimisht ne t’i dërgojmë një rekomandim Ministrisë së Drejtësisë e cila duhet ta trajtojë këtë çështje, të shoh edhe zbatimin e ligjit dhe brenda një afati të caktuar pastaj të bëjmë vizitën se a ka ndërmarrë masa lidhur me këtë çështje apo jo, sepse është çështje ekskluzive e tyre. Ajo çfarë më ka shqetësuar më shumë se të gjitha këto këta zyrtarë kanë bërë një referencë të gabuar ligjore kur ju kanë drejtuar komisionit.

Kryetarja- Potenco i se paralelisht me shkresën që mund ti dërgohet Ministres së Drejtësisë, unë mendoj që duhet ta bëjmë edhe një vizitë për vetë faktin e zbatimit të ligjit, sepse është evidente që ata me ligjin e ri duhet të ishin avokat të shtetit.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij tha se ne duhet të jemi të kujdesshëm sepse Avokatura Shtetërore është shumë e rëndësishme në mbrojtjen e ligjshmërisë së shtetit dhe përfaqësimit të institucioneve të Kosovës, qoftë para individëve dhe para organeve të drejtësisë. Z. Zemaj po ashtu propozoi që t’i dërgohet një shkresë ministres së Drejtësisë, lidhur me shqetësimet që i kanë paraqitur zyrtarët e Avokaturës së Shtetit deri në vizitën ministres së Drejtësisë. Ne duhet të dakordohemi dhe të shohim se sa është vënë në zbatim ligji në tërësi. Ndërkaq, kërkoi që kjo çështje të shqyrtohet me seriozitet për vetë institucionin tonë por edhe institucionet e tjera në përgjithësi.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Rekomandim

- I. Të shqyrtohen pretendimet e zyrtarëve të Avokaturës Shtetërore, lidhur me sjelljet e avokatit të përgjithshëm, z. Heset Mazrekaj.
- II. Të njoftohet Komisioni për veprimet e ndërmarra për këtë rast, më së largu deri më 23.9.2016.

7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Vërejtja ime është se në këtë projektligj kanë bërë amendamente duke ndërhyrë në ligjin bazik dhe rregullorja nuk e lejon një gjë të tillë. Unë personalisht nuk mund ta përkrah raportin sepse kam shumë vërejtje të projektligjit në tërësi. Mirëpo nuk janë marrë parasysh dhe kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni **me 6 vota për, 1 votë kundër dhe 2 vota abstenim**, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr. 05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent

Kryetarja- Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni **8 vota për dhe 1 votë abstenim** vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-24 për Shërbimin Mjekësor Emergjent dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

9. Të ndryshme.

A. Zëvendësimi i kryesuesit të Grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetarja- Në fjalën e saj tha se znj. Donika Kadaj- Bujupi ka qenë kryesuese e grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe tani duhet të zëvendësohet sepse znj. Donika Kadaj- Bujupi nuk është anëtare e komisionit për Legjislacion dhe kërkoi nga anëtarët që të japin propozimet e tyre.

Nezir Çoçaj- Propozoi Albulena Haxhiu për kryesimin e Grupit Punues për mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsion dhe tërhiqet nga Grupi punues i mbikëqyrjes së Agjencisë Kundër Korrupsion si anëtar i këtij grupi punues.

Selviqe Halimi- Propozoi Valdete Bajramin për kryesimin e Grupit Punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion.

Valdete Bajrami- Propozoi që kryesimi t'i mbetet anëtarit nga subjekti partiak i AAK-së.

Agim Aliu - Në fjalën e tij tha se pozita ka qenë shumë kundërshtuese dhe vetë kam qenë shumë kundërshtues ndaj punës së Agjencisë Kundër Korrupsion, që do të thotë se nuk ka munguar zëri i kundërt edhe nga pozita. Jemi dakorduar që në parim që opozita ta kryesojë Grupin punues për mbikëqyrjen e Agjencisë. Po ashtu edhe z. Aliu propozoi znj. Valdete Bajrami për kryesimin e Grupit punues.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash mori:

V e n d i m

Për zëvendësimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Grupit Punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion do të jetë në këtë përbërje:

Valdete Bajrmi, kryesuese
Albulena Haxhiu, anëtare
Armend Zemaj, anëtar
Agim Aliu, anëtar
Doruntinë Maloku, anëtare dhe
Danush Ademi, anëtar.

B. Rishikimi i planit të punës për sesionin vjeshtor

Kryetarja- Kërkoi që të formohet një grup punues për të rishqyrtuar planin e punës të cilin e kemi dërguar te disa shoqëri civile dhe disa prej tyre kanë dërguar propozime.

Selvije Halimi- Tha se administrata e komisionit në kohën kur është hartuar plani i ka njoftuar organizatat e shoqëritë civile dhe në bashkëpunim me ato është hartuar dhe plani.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni në mënyrë në mënyrë unanimiti vendosi që kjo pikë të shqyrtohet mbledhjen e ardhshme të radhës.

C. Caktimi i datës për raportim të ministres së Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, lidhur me mos zbatimin e rekomandime të Komisionit për Legjislacion për ndryshim dhe plotësim të ligjeve për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurial të Kosovës

Kryetarja- Tha se mendoj që është e rëndësishme që ta thërrasim në Dëgjim Publik ministren e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, dhe për shkakun se shumë rekomandime të Komisionit nuk janë miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Ministri Hajredin Kuqi nuk është treguar i përgjegjshëm me komisionin kur ne e kemi ftuar dhe shpresoj që kjo të mos ndodhë me ministren e re. Unë mendoj që ta thërrasim brenda 2 javëve ministren e Drejtësisë për çështjet që na shqetësojnë.

Selvije Halimi- Sa i përket ftesës së ministres unë mendoj që diku nga muaji, nëntor të ftohet në dëgjim publik dhe të njëjtën kohë t'i dërgojmë edhe axhendën për çështjet që do të trajtohen në dëgjim publik. Ministria e Drejtësisë nuk e ka një fushë të caktuar në mënyrë që të dalim me rekomandime të qarta nga Dëgjimi publik.

Kryetarja- Potenco i se Kuvendi e mbikëqyr punën e Qeverisë, e cila është edhe kategori Kushtetuese. Dëgjimi publik me ministren e Drejtësisë do të ketë në fokus rishikimin e Pakos ligjore të sistemit të Drejtësisë.

Armend Zemaj- Tha se interesim i komisionit tonë është mbarëvajtja e sistemit të drejtësisë dhe avancimi i punës së gjyqësorit. Në fokus të temave kryesore sigurisht që do jenë Këshilli Prokurorial i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe rekomandimet e komisionit për ligjin mbi e Ekzekutimin e Sanksionve Penale.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Dëgjimi Publik me ministren e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha, të jetë dt. 26.10. 2016

D. Njoftim

Kryetarja- Njoftoi anëtarët e Komisionit se Organizata 'Lëvizja Fol' ka bërë ftesë për dt. 16,17 dhe 18 për një punëtori e cila do mbahet në Durrës (Shqipëri), ku do të diskutohet me theks të veçantë Deklarimi i Pasurisë dhe Ligji Antimafia.

E. Diskutim në lidhje me emërimin e anëtarëve të Këshillit Prokurorial nga Kuvendi i Republikës së Kosovës nga radha e odës së avokatëve.

Kryetarja kërkoi që t'i dërgohet shkresë Odës së Avokatëve në mënyrë që të dërgojnë kandidatët e tyre për për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës me ndryshimet e fundit legjislative që janë bërë dhe ftoi anëtarët e komisionit që të marrin fjalën.

Meqë nuk kishte diskutime, kryetarja konstatoi se komisioni vendosi që Odës së Avokatëve t'i dërgoj këtë shkresë:

Propozimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Komisioni, kërkon nga Oda e Avokatëve të Kosovës që të ndërmarrë veprimet e nevojshme, që sa më parë të propozojë kandidatët, në mënyrë që Kuvendi ta përmbushë obligimin ligjor për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial, siç përcaktohet me nenin 3, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu